REPUBLIKA E KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 02-363
Data/Datum/Date: 17/03/2026
Shtojca/Dodaci/Annex -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Nr. 24 /2026
Datë: 17/03/2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 37 (paragrafi 1) të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave për
aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me lule për Ministrinë e Drejtësisë dhe njësitë e saj", me nr. të prokurimit 215-26-865-1-3-6, si në vijim:

1.1. Atdhe Berisha, Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative, Kryesues;

1.2. Sadedin Gerguri, Zyrtar për Shërbime Logjistike, Anëtar;

1.3. Valon Grashtica, Zyrtar i Lartë i Prokurimit, Anëtar.

2. Anëtarët e Komisionit obligohen që para fillimit të vlerësimit të ofertave të plotësojnë dhe nënshkruajnë deklaratën nën betim, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

3. Komisioni, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave vepron në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke respektuar dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

4. Pas përfundimit të vlerësimit, Komisioni i paraqet Zyrtarit të Prokurimit, raportin përfundimtar
të vlerësimit, rekomandimin përkatës si dhe arsyetimin që mbështet këtë rekomandim.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Anita KALANDERI

Sekretare e Përgjithshme

Vendimi iu dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Divizionit të Prokurimit;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*